

## **GJYKATA E QARKUT NË PEJË**

**P. Nr. 29/08**

**Data 23 Korrik 2010**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË PEJË**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it, Gianfranco Gallo, si gjyqtari kryesues, gjykatësi i EULEX-it, Riku Jaakkola dhe gjyqtari kosovar Isa Kelmendi, si anëtarë të panelit, të asistuar nga ana e Robina Struthers, Procesverbal Mbajtëse e Gjyqit, në çështjen penale kundër të akuzuarit

**VENTOR MAZNIKOLLI**, i biri i Rexhep Maznikollit dhe Ruke Berishës, i lindur më 5 Shkurt 1980 në fshatin Kosuriq, Komuna e Pejës, me banim në Pejë – në rrugën "Myrte Zeneli" nr.14, shqiptarë i Kosovës, i gjendjes së vështirë ekonomike, në liri

i akuzuar, sipas Aktakuzës PP. Nr. 437/03 të datës 20 Nëntor 2003, dhe të përmirësuar më 22 Korrik 2010, me veprën penale si në vijim:

*Vrasje e provokuar në kundërshtim me Nenin 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), të kryera më 23 gusht 2003, në Pejë.*

Pasi mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor publik më 2, 3 dhe 8 Qershor 2010, si dhe 21, 22 dhe 23 Korrik 2010 në prani të:

- Të akuzuarit, z. Venter Maznikolli, dhe avokatit të tij mbrojtës, z. Zenel Mekaj;
- Prokurorit Publik, z. Ali Uka,
- Palëve të dëmtuara, Kimete Belegu, Merita Nurcaj dhe Gezim Belegu;

pas shqyrtimit nga ana e Trupit Gjykues dhe votimit të mbajtur më 22 Korrik 2010, në pajtim me Nenin 345 të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP);

më 23 Korrik 2010, në pajtim me Nenin 351 të LPK, shpall publikisht, si në vijim këtë

### **AKTGJYKIM**

Venter Maznikolli

### **SHPALLET FAJTOR**

*për Vrasje të Provokuar në kundërshtim të Nenit 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), lidhur me vrasjen e Xhafer Belegut të kryer më 23 Gusht 2003, në Pejë, sepse pasi u soll, jo me fajin e vet, në një gjendje të irritimit të shkaktuar nga një sulm të rëndë të kryer nga ana e Xhafer Belegut kundër Rexhep Maznikollit, babai i të pandehurit, ai u provokua për të marrë jetën e Xhafer Belegut duke e qëlluar atë me një pistoletë e goditi viktimën në mënyrë vdekjeprurëse në pjesën e Parme të djathtë të trungut, kështu duke shkaktuar vdekjen e tij.*

PRANDAJ, i akuzuari

## DËNOHET

Me 8 vjet burgim për veprën penale të *Vrasjes së Provokuar në kundërshtim të Nenit 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK)*.

Koha e kaluar në Paraburgim nga ana e të paditurit, nga 23 Marsi i vitit 2007 deri më 8 Maj 2007, do t'i llogaritet në dënim, sipas Nenit 351, Paragrafi (1), Pika 6 të LPK-së.

I akuzuari do t'i mbulojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 351, Paragrafi (1), Pika 7 të LPP-së, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

## A R S Y E T I M

### A. SFONDI PROCEDURAL – AKTAKUZA

Më 21 Nëntor 2003 Prokurori Publik i Qarkut Paraqiti aktakuzën PP. Nr. 437/03 kundër Venter Maznikollit, duke e akuzuar për veprën penale të *Vrasjes* në kundërshtim me Nenin 30 Par. 1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), *Lëndim i Lehtë Trupor* në kundërshtim të dëmit në Nenin 39 Par. 2 i LPK-së, si dhe të *Posedimit të Paligjshëm të Armëve dhe të Municionit* në kundërshtim me Nenin 8, Par 8.5 në lidhje me Par. 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/7.

Sipas aktakuzes origjinale, më 23.08.2003, rreth orës 17:00, në oborrin e viktimës, për shkak të një grindje që ishte në vazhdimësi në mes të familjes së të pandehurit dhe familjes së viktimës, i pandehuri qëllimisht e vrau Xhafer Belegun.

Pas qëlloi mbi viktimën, i pandehuri goditi motrën e viktimës, Sanije Hoxha, me kondak të pistoletës së tij.

Shqyrtimi i Parë kryesor u përmbyll më 28 Janar 2004, me Aktgjykimin P. Nr.354/03 dhe i pandehuri u lirua lidhur me veprën penale të vrasjes, meqë u konsideruar se ai kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme, ndërsa u shpall fajtor për veprat penale të *Lëndimit të Lehtë Trupor* dhe *Posedimit të Paligjshëm të Armëve* dhe u dënua me 6 muaj burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur mbi ankesën e Prokurorisë, lëshoi Aktgjykimin Ap.Nr.423/2004, të datës 27.01.2005, me të cilën Aktgjykimi i shkallës së Parë u ndryshua lidhur me veprën penale të *Posedimit të Paligjshëm të Armëve*, kurse u konfirmua për veprën penale të *Lëndimit të Lehtë Trupor*, si dhe u anulua sa i perket lirimit të të pandehurit lidhur me veprën penale të *Vrasjes* dhe rasti iu këthye gjykatës së shkallës së Parë për rigjykim.

Rigjykimi filloi më 22 Janar 2006: i akuzuari nuk u Paraqit në seancën e Parë dhe për këtë arsye u arrestua dhe Paraburgimi është urdhëruar kundër tij për një periudhë prej dy muajsh. Më 8 Maj 2007 gjykimi përfundoi dhe i pandehuri u lirua përsëri, sepse, sipas Aktgjykimit P.Nr.67/05, vrasja është kryer në mbrojtje të nevojshme. Me një aktvendim të veçantë, Paraburgimi u ndërpre të njëjtën ditë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur mbi ankesën e Prokurorisë, lëshoi Aktvendimin, Ap.Nr.369/2007, të datës 06.12.2007, me të cilin ankesa e Prokurorit u aprovua dhe Aktgjykimi i shkallës së Parë u anulua: rasti i është kthyer përsëri gjykatës së shkallës së Parë për rigjykim, duke veçuar se rasti duhej shqyrtuar nga një Trup Gjykses tjetër.

Më 28.12.2009 Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Pejë i Parashtrroi një kërkesë EULEX-it që të marrë përsipër çështjen dhe më 21.01.2010, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, pas një seance dëgjimi, vendosi që Gjyqtarët e EULEX-it të marrin përsipër rastin.

## **B. KOMPETENCA E GJYKATËS**

### **1. Ligjin në fuqi, Kompetencat dhe Përbërja e Trupit Gjykses i Gjykatës së Qarkut të Pejës.**

Aktakuza është ngritur më 20 Nëntor 2003. Siç është e njohur mirë, sipas Nenit 550 të KPPK-së, procedimet penale në shkallën e Parë, me çrast aktakuza ishte ngritur Para datës së hyrjes në fuqi të KPPPK-së (6 Prill 2004), por të cilat nuk kishin përfunduar deri në këtë datë, do të vazhdonin në pajtim me dispozitat e ligjit të mëparshëm në fuqi, do të thotë të Ligjit të Procedurës Penale të vitit 1986.

Në përputhje me Nenin 23, Paragrafi 1 të LPK-së në lidhje me Nenin 29 Par. 2 nën Par. 1 i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të vitit 1978, Gjykatat e qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim për më shumë se pesë vjet.

Në rastin në fjalë i akuzuari fillimisht ishte ngarkuar me *Vrasje* dhe më pas akuza u ndryshua në *Vrasje të Provokuar* në pajtim me Nenin 33 të LPK-së, dënohet prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet burgim dhe është e pakontestueshme se që të dy veprat penale janë në kompetencë të Gjykatës së Qarkut.

Veprat penale, sipas aktakuzës, janë kryer në Pejë, prandaj rasti bie nën kompetencë territoriale të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Rastin në fjalë iu caktua në kompetencë të Gjyqtarëve të EULEX-it nëpërmjet një vendimi të Presidentit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it më datën 21.01.2010, në pajtim me Nenin 3.3 dhe 3.4 të Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë .

### **2. Shqyrtimi Kryesor**

Shqyrtimi kryesor gjyqësor është mbajtur publikisht në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Pejë më 02, 03 dhe 08 Qershor 2010, si dhe 21, 22 dhe 23 Korrik 2010 në prani të Prokurorit Publik, të Pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe palës së dëmtuar.

Në përputhje me Nenin 7 të LPP-së, përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen gjatë procesit gjyqësor si dhe të gjitha dokumentet gjyqësore të rëndësishme për shqyrtimin kryesor gjyqësor nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas, si dhe kur ishte e nevojshme.

### **C. PËRMBLEDHJA E PROVAVE TË PARAQITURA**

1. Gjatë procesit të shqyrtimit kryesor gjyqësor janë marrë në shqyrtim i pandehuri dhe dëshmitarët si në vijim:

- a) I pandehuri Venter Maznikolli, u shqyrtua më 2 Qershor, 2010
- b) Kimete Belegu, u shqyrtua më 3 Qershor, 2010
- c) Merita Nurcaj, u shqyrtua më 3 Qershor, 2010
- d) Sanije Hoxha, u shqyrtua më 3 Qershor, 2010
- e) Rexhep Maznikolli, u shqyrtua më 8 Qershor, 2010
- f) Rukije Maznikolli, u shqyrtua më 8 Qershor, 2010
- g) Dr Bujar Berisha (dëshmitar ekspert), u shqyrtua më 21 Korrik, 2010
- h) Dr Nazife Sulejmani-Hulaj (dëshmitar ekspert), u shqyrtua më 21 Korrik, 2010

2. Deklaratat, raportet e policisë dhe dëshmitë e tjera të dokumentuara u lexuan gjatë seancave gjyqësore.

#### *2. a) Dëshmitë e dokumentuara dhe raportet*

Gjatë shqyrtimit kryesor, dokumentet në vijim u lexuan si provë, në pajtim me Nenin 332 të LPP-së:

- Raporti Fillestar i Policisë, numri i rastit 2003-DA-2569 i datës 23.08.2003;
- Raporti i Zyrtarit të Policisë Nr. i rastit 2003-DA-2569 i datës 23.08.2003, i përpiluar nga Zyrtari i Enver Seferi #4207;
- Raporti i zyrtarëve të policisë Nr i rastit 2003-DA-2569 i datës 23.08.2003, i përpiluar nga Zyrtari Zafar Khaled Ebu #11781;
- Raporti i Zyrtarëve të policisë, Nr i rastit 2003-DA-2569 i datës 23.08.2003, i përpiluar nga Zyrtari Astrit Tolaj #2272;
- Raporti i Zyrtarëve të policisë, Nr i rastit 2003-DA-2569 datë i datës 23.08.200, i përpiluar nga Zyrtari Muhamed Çallakaj #2507;
- Ekzaminimi Mjekësor i të pandehurit Venter Maznikolli, i datës 24.08.2003, i ekzaminuar dhe i përpiluar nga Dr Arif Ramosaj, mjek i mjekësisë së përgjithshme;
- Raporti Mjekësor i viktimës Xhafer Belegu, i datës 26.08.2003 i përpiluar nga Dr Fatlum Maraska, kirurg;

- Fletëlëshimi me historinë e ekzaminimit mjekësor të Rexhep (Dine) Maznikollit, i datë 15.09.2003, përpiluar nga Dr Mithat Jakupi, ortoped;
- Raporti i vendit të ngjarjes së krimit, i datës 24.03.2003, skica e vendit të krimit, legjenda dhe fotot e vendngjarjes të përpiluara nga Zyrtarja Cucë Kelmendi #3059;
- Raporti i Ekzaminimit të Automjetit në lidhje me automjetin e viktimës, Xhafer Belegu, makina e tipit "Opel Kadet", si dhe makina e të pandehurit, Venter Maznikolli, makina e tipit "Volksäagen Passat", të përpiluar nga Zyrtari Riza Rexhiqi #3080, si dhe Foto Albumi i ekzaminimit të automjetit i përgatitur nga Zyrtari Sokol Dedaj #4362;
- Kallëzimi penal kundër Venter Maznikollit, i datës 25.08.2003, përpiluar nga zyrtarët Isuf Haklaj #0065 dhe Sabahate Tolaj #2745;
- Raporti i Autopsisë së viktimës Xhafer Belegu, i datës 24.03.2003, i përpiluar nga Dr Marek Gasior, si dhe foto albumi i përgatitur nga Zyrtari i autopsisë Sokol Dedaj #4362;
- Raporti balistik i datës 26.09.2003, i përpiluar nga Yuriy Nesterchuk dhe Çlirim Ajdini, ekspertë të balistikë;
- Raporti për thërmi-mbeturinat e barutit, protokoll nr. 518, i datës 17.09.2003, përpiluar nga Cvetan Nishev, ekspert në Institutin e Kërkimeve të Mjekësisë Ligjore - Ministria e Punëve të Brendshme - Republika e Bullgarisë;
- Ekspertiza Psikiatrike e datës 23 Dhjetor 2003, e përpiluar nga Dr Gani Rama.

## 2. b) Deklaratat

Në pajtim me Nenin 333, Par. 2 të LPP, në bazë të konsensusit të palëve (shih procesverbalin e seancës së mbajtur më 08 Qershor 2010), nga deklaratat në vijim janë lexuar si prova, duke zëvendësuar shqyrtimin e drejtpërdrejtë të dëshmitarëve në vijim:

- Pasqyra e specialistit mjekësor, Dr Isa Kalijani, dhënë para Trupit Gjykses, të datës 21.04.2004;
- Deklarata e ekspertit të mjekësisë ligjore, Dr Arsim Gërxhaliu, dhënë para Trupit Gjykses, të datës 08.05.2007;
- Deklarata balistike e ekspertit, Hazir Kelmendi, dhënë para Trupit Gjykses, të datës 05.08.2007;

## D. RINDËRTIMI FAKTIK I NGJARJES

Në pjesën në vijim të arsytimit do të prezantohen deklaratat të ndryshme në lidhje me ngjarjet më të rëndësishme të çështjes aktuale.

**Marrëdhëniet në mes të familjes Maznikolli dhe familjes Belegu**

Sipas të pandehurit, marrëdhëniet në mes të dy familjeve nuk ishin të mira<sup>1</sup>. I pandehuri<sup>2</sup> dhe i ati i tij Rexhep Maznikolli<sup>3</sup> rikujtojnë se para luftës familja e tyre e kishte një lopë, e cila e bënte jashtëqitjen ndonjëherë para shtëpisë së Xhafer Belegut dhe për këtë arsye marrëdhëniet mes dy familjeve u tensionuan. Çështja nuk është zgjidhur kurrë, edhe pse shtëpitë ku kanë jetuar dy familjet ishin përballë e njëra-tjetrës.

Kjo rrethanë se marrëdhëniet mes dy familjeve nuk ishin të mira është konfirmuar edhe nga pala e dëmtuar Kimete Belegu.

### **Grindja në lidhje me vrimën në rrugë në mes të dy shtëpive dhe të shtënat e shkrepura nga Xhafer Belegu.**

Sipas palës së dëmtuar *Kimete Belegu*, disa ditë para vrasjes, ndodhi një shpërrthim i tubave të ujit, të cilat gjendeshin nën rrugë në mes të dy shtëpive. Të premtën, më 22 Gusht, një ditë para vrasjes, ekipi i mirëmbajtjes nga departamenti i ujësjellësit arriti, e riparoi prishjen dhe e mbuloi vrimën me dhe.

Kimetja deklaroi se vrimë në të vërtetë nuk ishte mbushur siç duhet dhe që, në natën e 22 Gushtit, djali i saj kishte rënë me një pjesë të makinës së tij në vrimë. Vrima gjendej në rrugë në mes të dy shtëpive, por më afër portës së oborrit të Xhafer Belegut. Të nesërmen, pas dite, burri i saj Xhafer Belegu deshti të rregullonte vrimën. I veshi rrobat e punës dhe e mori karrocën, shkoi me marr pakës dhe dhe filloi të mbushë vrimën. Kimetja ishte në ballkonin e shtëpisë së saj me të bijën e saj Merita Nurcaj dhe me kumatën Sanije Hoxha (nga kjo pozitë ato e kishin një pamje të qartë të rrugës dhe të vrimës). Menjëherë pas kësaj, Rexhep Maznikolli arriti në vendin e ngjarjes dhe filloi të ankohet për ndërhyrjen e Xhaferit gjë që, sipas Rexhepit, mund të shkaktojë plasaritjen e tubave përsëri. Rexhep gjithashtu e theksoi se ai tashmë kishte paguar 20 euro për riparimin e tubave. Pastaj filloi një fjalosje në mes të dy burrave; Kimetja e pa Rexhepin duke kapë një shufër hekuri që gjendej aty dhe thërriti Rexhepin: "*Për hir të Zotit, largohu*".

Sipas Kimetes, burri i saj, Xhaferi, hyri brenda në oborrin e shtëpise dhe e mori makinën e tij, ndërsa Rexhepi i tha atij: "*Ti nuk guxon me kalu me makinën tënde këndeje pari*" (që do të thotë të nget makinën mbi vrimë). Pastaj ajo e pa burrin e saj duke ngarë makinën dhe ndaloi tek porta e oborrit. Ajo e dalloj atë duke e shtrirë dorën e tij nga dritarja në anën e majtë të makinës dhe duke mbajtur një armë në dorë. Sipas asaj që është deklaruar nga Kimetja para Trupit Gjykses, burri i saj qëllon një herë në ajër posa e pa Rexhepin të vinte në drejtim të tij me një shufër hekuri në dorë, ndërsa para Gjyqtarit Hetues ajo pohoi se burri i saj qëllon dy herë në ajër.

E ballafaquar me deklaratën e saj të mëparshëm nga Trupi Gjykses, ajo tha se nuk kishte dëgjuar të shtëna të tjera përveç të parës<sup>4</sup>, sepse, pasi që grindja kishte eskaluar, ajo ishte e

<sup>1</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 02.06.2010, faqe 17 dhe 19 (verzioni Anglisht – v.Ang)

<sup>2</sup> Procesverbal i shqyrtimit të mëhershëm kryesor të datës 19.01.2005, faqe 5 (v.Ang)

<sup>3</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor, të datës 08.06.2010, faqe 11 (v. Ang)

<sup>4</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 03.06.2010, faqe 12;

Gjyqtari Kryesues: *pra nuk ju kujtohet sa të shtëna janë shkrepur në ajër?*

Kimete Belegu: *jo, në atë çast isha e humbur.*

Gjyqtari Kryesues: *pas asaj të shtëne në ajër, a dëgjuat ndonjë të shtënë të shkrepur nga ana e burrit të juaj?*

Kimete Belegu: *jo më, përveç të njëjës që ai e shkrepri nga makina e tij në vetëmbrojtje.*

shqetësuar për nipin e saj dhe ishte në kërkim të tij. Për të njëjtën arsye, ajo nuk mund të shihte se Rexhepi ishte plagosur. Kur u këthye në ballkon, e pa burrin e saj duke ngarë mbrapa makinën brenda në oborr, doli nga makina dhe u nis drejt garazhës. Atëherë ajo e kuptoi se Rexhepi ishte plagosur dhe e pa të pandehurin duke hyrë në oborrin e saj dhe duke e treguar armën e tij në drejtim të njerëzve në ballkon.

Sipas palës së dëmtuar *Merita Nurcaj*, në ditën kritike, ajo shkoi me babain e saj, Xhafer Belegu, për të bërë pazar dhe kur u këthyen, Xhafer i veshi rrobat e tij të punës, sepse donte me e mbushë vrimën. Gjersa punonte Xhaferi në vrimë, Rexhep Maznikolli doli dhe filloi të kërcënonte babain e saj. Prandaj Xhaferi shkoi në oborrin e tij, e mori makinën dhe e derjtoi atë deri te porta e oborrit. Kur Xhaferi iu afrua portës, Rexhepi ngriti shufrën e hekurit dhe ndërkohë babai i saj, Xhaferi, shtriu dorën e tij nga dritarja e makinës dhe shkrepiti të shtëna dy herë.

Para gjykatësit hetues dëshmitari ka pohuar se babai i saj qëllon një herë në ajër. E ballafaquar me deklaratën e saj të mëparshëm, ajo tha se dëgjoji dhe pa dy të shtënat në ajër, sepse ajo ishte duke shikuar në atë drejtim<sup>5</sup>.

Kur dëgjoji të shtënat, ajo menjëherë hyri në shtëpi dhe u drejtua në drejtim të pjesës së pasme të shtëpisë që të kujdeset për djalin e saj. Kur u sigurua se nuk ishte në rrezik, ajo u kthye në ballkon, por të shtënat tashmë kishin përfunduar.

Në deklaratën e dhënë policisë më 1 Shtator 2003, ajo pohoi se e kishte vërejtur babain e saj të kishte shkrepur i pari në ajër dhe pastaj në Rexhepin, por pa ndonjë qëllim për ta vvarë. Në fakt, sipas dëshmitarëve, meqë Rexhepi dhe Xhaferi ishin shumë afër njëri tjetrit, nëse ky i fundit donte me të vërtetë për ta vvarë Rexhepin, do ta kishte shumë lehtë për ta bërë këtë. E ballafaquar me këtë pjesë, ajo nuk e mohoi të ketë thënë fjalët e mësipërme.<sup>6</sup>

Sipas dëshmitares *Sanije Hoxha*, në ditën kritike, një fjalosje ndodhi në mes të vëllait të saj, Xhafer Belegu, dhe Rexhep Maznikollit, për shkak të disa tubave të ujit. Xhaferi dhe Rexhepi grindeshin në rrugë para portës së oborrit të Xhaferit. Rexhepi e kishte një shufër në dorë dhe i afrohej Xhaferit duke thënë: "*Shiko Xhafer, kjo më ka kushtuar 20 Euro për ta riparuar dhe nëse prishet, kam me ta thye kokën*". Pastaj sipas dëshmitares, ajo ndërhyri duke thënë fqijut: "*fqinj i dashur, nuk është problem 20 euro, shkoni në shtëpi, mos të bëjmë bujë të madhe në lidhje me këtë*". Ajo tha kështu, sepse kishte dëgjuar se një tjetër fqinj ishte sulmuar nga Rexhepi dhe për këtë arsye kishte frikë. Menjëherë pas kësaj ajo e pa nga ballkoni ku gjendej vëllaun e saj të ngiste (makinën) drejt portës së oborrit të tij. Pastaj e pa Rexhepin në përpjekje për të goditur vëllaun e saj, Xhaferin, me një shufër të hekurt, si dhe Xhaferi duke tërhjekë dorën e tij nga dritarja e makinës dhe duke qëlluar dy herë në ajër.

Përbalë Gjyqtarit Hetues më 9 Shtator 2003, dëshmitarja kishte deklaruar se Xhaferi kishte shtënë një herë në ajër dhe herë e dytë në krahun e Rexhepit. E ballafaquar me mospërputhje, e mohoi se kishte thënë se vëllai i saj kishte shtënë në Rexhepin<sup>7</sup>.

Sipas dëshmitarit *Rexhep Maznikolli*, dy ditë para vrasjes ai kishte pasë disa probleme me

---

*Gjyqtari Kryesues: a jeni në dijeni se babai i të pandehurit është plagosur nga e shtëna?*

*Kimete Belegu: më herët e thash se kur u plagos nuk e pashë, por ishte motra e burrit tim të ndjerë që e pa këtë.*

<sup>5</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 03.06.2010, faqe 22 (v. Ang)

<sup>6</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 03.06.2010, faqe 26 (v. Ang)

<sup>7</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 03.06.2010, faqe 32 dhe 33 (v. Ang)

tubat e ujit. E kishte ftuar departamentin e ujësjellësit dhe punëtorët e kishin riparuar prishjen për një çmim prej 20 DM. Në ditën kritike, kur doli nga shtëpia e tij, e pa Xhafer Belegun duke mbushur me pakës dhe vrimën ku tubat e ujit gjendeshin dhe kërkoi nga Xhaferi që mos të shkelte mbi të deri sa të ngurtësohej; Xhaferi u përgjigj se, meqë vrima gjendej para derës së tij, mund të bënte çdo gjë dhe kur Rexhep përsëriti kërkesën e tij ai u përgjigj: "*Prit, unë do të të tregoj*". Menjëherë pastaj ai shkoi për të marrë makinën e tij ndërsa Kimetja thërriste në atë çast: "*Mos, Xhafer*", në ndërkohë Sanija zbriti shkallët dhe u ndal para makinës për ta ndaluar atë, por rrëshqiti dhe ra duke e goditur parakolpin. Në këtë çast Kimetja u këthye dhe i tha Rexhepit me ikë. Pastaj Xhaferi drejtoi makinën deri tek porta e oborrit të tij, e hapi dritaren e makinës poshtë dhe nxorri dorën e tij duke mbajtur një armë. Rexhep i tha Xhaferit mos të qëllonte, por ndërkohë u godit nga një plumb. Menjëherë pas kësaj, të shtëna të tjera u shkrepën duke goditur Rexhepin në gjoks dhe në dhe krahun e majtë.

Para Gjykatësit Hetues, Rexhepi deklaroi se e shtëna e parë e huqi atë, ndërsa e dyta e goditi në gishtin e madh. Lidhur me këtë mospërputhje dëshmitarit shpjegoi se ishte në spital dhe padyshim i shqetësuar kur gjykatësi hetues e morri në pyetje. Duke ia përkujtuar se para policisë e kishte dhënë të njëjtin version, ai u arsyetua se kishte qenë i hutuar dhe se nuk i kujtohej.<sup>8</sup>

Dëshmitari ka deklaruar më pas se, pasi është goditur, kishte rra në gjunjë dhe kishte dëgjuar djalin e vet, Vektorin, duke bërë në Xhaferin: "*Mjaft, lëshoje armën, a nuk e sheh se ma vrave babain*", Xhafer u përgjigj si në vijim: "*Eja këtu dhe ta bëjë sikurse babait tënd*".

Sipas dëshmitares *Rukije Maznikolli*, në ditën kritike ajo kishte kërkuar nga burri saj, Rexhepi, për të shkuar me ble disa gjëra për shtëpi. Ia kishte shkruar atë në një copë letër dhe doli për t'ia dhënë atë Rexhepit. Kur doli jashtë, e pa burrin e saj pranë vrimës duke folë me Xhaferin. Ajo mund të dëgjojë burrin e saj duke shqiptuar fjalët si në vijim: "*Fqinj, prisni edhe dy ditë deri sa toka të flejë ne vend të vet, mos e shkel dhe atëherë nuk do të ketë asnjë problem*". Pastaj e dëgjoi Xhaferin duke u përgjigjur: "*Fqinj, ju doni të ndërhyni përpara shtëpisë sime, pra pritni aty dhe unë ua tregoj*". Pastaj Xhaferi shkoi në drejtim të makinës së tij, hyri në të dhe u drejtua drejt Rexhepit. Në atë kohë Kimetja qëndroi përballë Xhaferit dhe i tha Rexhepit: "*Ik, largohu*".<sup>9</sup> Pastaj motra e Xhaferit, Sanije Hoxha, e kapi Kimeten nga krahu dhe i tha: "*Lëre, le ta bëjë*". Kur Sanija e tërhjeku Kimeten, ajo ra anash prej makine. Menjëherë Xhafer drejtoi makinën deri tek porta e oborrit, hapi dritaren poshtë dhe filloi të shkrepë të shtëna drejt Rexhepit, i cili ra në gjunjë dhe u mbulua me gjak. Ajo menjëherë hyri në shtëpi në mënyrë që të merr disa fasha për plagët, e pa djalin e saj duke folur në telefon dhe i tha: "*Ventor, nxito jashtë, Rexhepi u vra, ta dërgojmë në spital*". Vektor doli jashtë dhe gjer sa ajo ishte në shkallë, e vërejti Xhaferin duke iu drejtua me armë Vektorit dhe babait të tij dhe duke mos e lejuar Vektorin të ndihmojë Rexhepin. Pastaj Xhaferi bërtiti: "*Ku po shkon*" dhe shkrepë disa të shtëna kundër Vektorit.

Përballë Gjyqtarit Hetues, më 10 Shtator 2003, dëshmitari tha se "*posa doli Vektorin në rrugë, Xhafer Belegu shkrepë dy ose tri herë në Vektorin, por Vektorin shpejt u këthye në shtëpi dhe doli me një pistoletë në dorë*". E ballafaquar ludhur me këtë mospërputhje, ajo nuk e konfirmoi deklaratën e mësipërme duke u arsyetuar se nuk e kishte kuptuar se çfarë është thënë nga Gjykatësi Hetues, pasi ai fliste në gjuhën boshnjake.<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2010, faqe 5 – 6 dhe 13 – 14 (v.Ang)

<sup>9</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2010

<sup>10</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2010, faqe 21 (v.Ang)

Përballë Trupit Gjykues asaj nuk i kujtohej sa të shtëna janë shkrepur kundër Ventorit, ndërsa në dy shqyrtimet kryesore të mëparshme (më 21.01.2004 dhe më 07.05.2007) ajo kishte deklaruar se ka pasë dy ose tri të shtëna kundër Ventorit.<sup>11</sup>

Dëshmitari shtoi se, pas të shtënave, Ventori ishte fshehur pas një shtylle dhe, gjersa ishte në përpjekje të ndihmojë burrin e saj, dëgjoi djalin duke thirrur: "*Fqinj, lëshoje armën, e sheh se e ke vrarë babain tim*", pastaj dëgjoi Xhaferin duke u përgjigjur: "*Ah, kam me ta bo më keq se babës*" dhe ai shkrepri përsëri dy ose tri herë në drejtim të Ventorit.

I pandehuri Ventor Maznikolli deklaroi se gjendej në dhomën e ndejes në shtëpi duke folur në telefon me dajën kur nëna e tij hyri dhe i tha: "*Ventor, dil jashtë dhe dërgoje babain në spital, sepse është qëlluar*". Ai doli jashtë dhe pa babanë e tij në gjuhë, me gjoks të mbuluar me gjak. E humbi veten. Iu afrua babait, në mënyrë që ta ndihmojë, por Xhafer filloi të bërtas në duke i thënë se do t'ia bënte më keq se babait të tij, e drejtoi armën nga ai dhe pastaj filluan të shkrepë shtëna. I pandehuri u zhvendos nga vendi ku gjendej dhe u fsheh prapa cepit të shtëpisë së viktimës, në brendësi të oborrit dhe i tha Xhaferit të lëshojë armën, por Xhaferi vazhdoi të qëllonte me armë.

### **Reagimi i të pandehurit dhe vrasja e Xhafer Belegut**

I pandehuri deklaroi se, pasi që Xhaferi kishte shtënë në atë, ai e tërhoqi armën e tij nga brezi i tij dhe e qëlloi nga prapa shtylla dy herë. Ai nuk e shikoi se çfarë kishte ndodhur me viktimën, por e la oborrin dhe shkoi për të ndihmuar babain e tij.

Sipas të palës së dëmtuar *Kimete Belegu*, pasi që kishte siguruar nipin e saj, u këthye në pjesën e parme të shtëpisë dhe mund të shihte të pandehurin duke hyrë në oborrin e saj me armë të drejtuar mbi ta. Burri i saj, pasi që tashmë kishte qëlluar me armë, e kishtëkëthyer mbrapa makinën në oborr, doli nga makina dhe u shkante në drejtim të garazhës dhe kopshti në pjesën e prapme të shtëpisë. Kur e pa të pandehurin duke hyrë në oborr, ajo bërtiti duke thënë: "*O Zot, bir*". Por i pandehuri shkoi në skajin e shtëpisë, e mbështet në shtyllë dhe shkrepri të shtëna. Burri i saj nuk ishte duke shkrepur të shtëna, meqë ishte duke shkuar në pjesën e prapme të shtëpisë. Pala e dëmtuar shtoi se kur i pandehuri ishte mbështetur pas murit, iu drejtua burrit me fjalët në vijim: "*Mos ik*".

Sipas palës së dëmtuar *Merita Nurcaj*, kur u këthye në ballkon, ajo e pa të pandehurin, i cili ishte ende në oborr, afër, buzë shtëpisë.

Përballë Gjykatësit Hetues ajo tha se kishte dëgjuar kur i ky njeri i ri kishte thënë: "*Shko mere femijën*". E ballafaquar me këtë pjesë, nuk i kujtohej të ketë thënë fjalë të tilla.<sup>12</sup> Pastaj e pa të pandehurin duke u tërhequr në drejtim të shtëpisë së tij duke drejtuar armën në njerëzit në ballkon

Përballë Trupit Gjykues dëshmitari tha se nuk e ka parë nëse i pandehuri e kishte goditur Sanijen. Gjatë shqyrtimit të parë kryesor, më 20.01.2004, ajo deklaroi se e kishte parë Ventorin në cepin e shtëpisë me pistoletë; halla e saj Sanija ishte pranë tij duke u përpjekur ta

<sup>11</sup> Procesverbal I shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2010, faqe 19 – 21 (v.Ang)

<sup>12</sup> Procesverbal I shqyrtimit kryesor të datës 03.06.2010, faqe 23 (v.Ang)

qetësonte, por Ventori e goditi në krah dhe në kokë me pistoletë. Pasi që u ballafaqua, ajo deklaroi se qëndronte pranë deklaratës së saj të mëparshme.<sup>13</sup>

Dëshmitarja *Sanije Hoxha* deklaroi se e pa një burrë me një armë duke hyrë në oborr, duke u mbështetur në shtyllë buzë shtëpisë dhe filloi duke shtënë në Xhaferin. Në ndërkohë vëllai i saj qëllonte në Ventorin nga pjesa e prapme e shtëpisë. Meqë kjo rrethanë e veçantë (për faktin se i pandehuri dhe viktima ishin duke qëlluar me armë në njëri-tjetrin) nuk kishte dalë në pah në deklaratat e saja të mëparshëm, ajo u ballafaqua nga ana e Trupit Gjykues lidhur me këtë pikë (shih procesverbalin e datës 06.03.2010, faqe 33-39 dhe në veçanti faqe 37).<sup>14</sup> Dëshmitari shtoi se ajo iu kishte afruar të pandehuri dhe e kishte lutur duke thënë: "*O djali im, mos gjuaj, unë mund të bëhem nëna jote*", por Ventori shkoi në drejtim të saj dhe e goditi në qafë me kondak të armës.

Sipas dëshmitarit *Rexhep Maznikolli* kur ai ra në gjunjë, tashmë iu kishte errësuar. Ai nuk e humbi vetëdijen, por nuk mund të shihte nëse Xhaferi ishte në makinë apo jo. Sidoqoftë, mund të dëgjonte djalin e tij dhe Xhaferin duke shkëmbyer fjalë dhe menjëherë pastaj dëgjoi tri të shtëna të forta dhe dy të tjera më të vogla.

Rexhepi pohoi se të shtënat kanë qenë të njëpasnjëshme dhe se kjo ishte çështje e çastit: tri të shtënat e para tingëllonin njësoj sikurse të shtënat që u shkrepën kundër tij. Menjëherë pasi i kishte dëgjuar të shtënat, e kishte humbur vetëdijen.

Sipas dëshmitares *Rukije Maznikolli*, Ventor e kishte drejtuar pistoletën në Xhaferin dhe kërkoi të lëshonte armën, por Xhaferi u përgjigj: "*Nuk e lëshojë*", menjëherë pastaj qëlloi tri herë në drejtim të Ventorit, i cili, vetëm në fund të fundit, reagoi duke qëlluar në Xhaferin (dëshmitarit nuk i kujtohet sa herë).<sup>15</sup>

## Ngjarjet menjëherë pas të shtënave

<sup>13</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor, të datës 03.06.2010, faqe 25

<sup>14</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor, të datës 03.06.2010, faqe 37

Sanije Hoxha: Në bazë të asaj se çfarë thanë policia lidhur me gëzhojat dhe ata që shkrepën të shtënat, jam shumë e sigurtë.

Kryetari Kryesues: Por juve jeni duke supozuar. Juve jeni të paraparë të raportoni se çfarë keni parë. Meqë nuk jeni eksperte, nuk mund të bëni supozime. A është e qartë? Mund të imagjinoni çfarë të doni.

Sanije Hoxha: Këto janë gjëra që kam parë me sytë e mia. I kam përjetu këto momente dhe që atëherë po lëngojë.

Gjyqtari Kryesues: Gjatë shqyrtimit të parë kryesor, juve thatë "kur Xhafer Belegu shkrepri me revole, ai ishte në makinë. Nuk më kujtohet sa herë ka qelluar. Ventori qëllonte me revole të tij. Dhe bërtiti "mos ik, mos ik". Nuk e di sa herë qëlloi. Pastaj shtuat, Xhafer Belegu nuk kishte asgjë në dorë". Këto janë fjalët e tuaja. Kurse në shqyrtiminë dytë kryesor juve thatë saktësisht të njëjtën gjë. Si mund të thuani se ata shkrepnin të shtëna kundër njëri tjetrit sepse keni thënë se ai nuk kishte asgjë në dorë? Me falni, juve nuk keni qenë prezente në shqyrtimin e dytë kryesor, por në shqyrtimin e parë kryesor juve thatë se vëllau i juaj, gjer sa Ventori qëllonte me armë në drejtim të tij, nuk kishte asgjë në dorë. Si është e mundur se ata qëllonin në njëri tjetrin meqë ai nuk kishte revole?

Sanije Hoxha: Këto nuk janë fjalët e mia, nuk e di se kush i ka shtuar këto fjalë.

Gjyqtari Kryesues: Pra, juve nuk qëndroni praën kësaj deklaratë?

Sanije Hoxha: Nga shqyrtimi parë kryesor?

Gjyqtari Kryesues: Po.

Sanije Hoxha: Qëndrojë praën deklaratës së dhënë në shqyrtimin e parë kryesor.

<sup>15</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2010, faqe 19 -20.

Pala e dëmtuar, *Kimete Belegu*, shpjegoi se, pasi që Ventori kishte shtënë në burrin e saj, i pandehuri u tërhoq duke ecur këmbë prapa dhe duke drejtuar armën në drejtim të tyre. Ajo u vërsul në rejtje të burrit të saj dhe e gjeti afër garazhës.

Pala e dëmtuar, *Merita Nurcaj*, shpjegoi se kur u këthye në ballkon dhe e kuptoi se të shtënat mbaruan, ajo e pa Ventorin pas shtyllës buzë shtëpisë. Ajo deklaroi se kur Ventori po largohej, e drejtoi armë në drejtim të saj. Asaj nuk i kujtohej se kush tjetër gjendej në oborr.

Dëshmitarja *Sanije Hoxha* deklaroi se, shpejti pasi që të shtënat përfunduan, dëgjoi vëllain e saj duke kërkuar ujë, kurse i pandehuri shkoi të ndihmonte babain e tij.

Sipas dëshmitares *Rukije Maznikolli*, pasi të shtënat përfunduan, Ventori erdh t'i ndihmonte babait të tij. Nëna dhe djali e vunë Rexhepin në makinë dhe Ventor e dërgoi në spital, kurse ajo hyri në shtëpi.

### **3. Provat plotësuese dhe të dhënat e siguruar gjatë seancave të shqyrtimit kryesor.**

Gjykata sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) kërkoi nëse ekzistonte dosje penale ndaj të pandehurit në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Komunale të Pejës. Sipas procesverbalit, i pandehuri e kishte vetëm një dënim të mëhershëm lidhur me një vepër tjetër penale (të Lëndimit të Lehtë Trupore dhe Posedimit të Paligjshëm të Armëve dhe të Municionit) të kryer të njëjtën ditë të vrasjes.

## **E. VLERËSIMI I PROVAVE TË PARAQITURA DHE KUALIFIKIMI LIGJOR**

### **1. Konstatimet faktike dhe ekzaminimi i provave**

Pas prezantimit të dëshmive dhe deklaratave më lartë, lidhur me rikonstruimin faktik të ngjarjeve që kanë ndodhur në ditën vendimtare të 23 Gushtit 2003, pikat në vijim mund të konsiderohen si të dëshmuara dhe pa dyshim, në bazë të autopsisë, inspektimit të ngjarjes, dëshmive të dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve ekspert, si dhe pranimet të të pandehurit:

- Më 23 gusht 2003 Xhafer Belegu u vra nga Ventor Maznikolli i cili qëlloi mbi të dy herë;
- Autopsia (shih raportin e autopsisë të datës 8 Shtator 2003) ka vërtetuar se viktimat është goditur nga një e shtënë në gjoks dhe kjo plagë e shkaktuar vdekjen e tij;
- Xhafer Belegu, para se të vritej, qëlloi në Rexhep Maznikollin, babain e të pandehurit, duke i shkaktuar atij pesë plagë;
- Raporti nga vendi ngjarjes ka konstatuar se, në vendin e ngjarjes, pesë gëzhoja të kalibrit 7,62 dhe dy gëzhoja të kalibrit 7,65 janë gjetë;

- Raporti balistike i datës 26 Shtator 2003 ka konstatuar se dy fishekë të kalibrit 7,65 mm janë shkrepur nga pistoleta Star 7,65 x 17 mm në posedim të Vektor Maznikolli;
- I njëjti raport balistik ka konstatuar se pesë fishekë të kalibrit 7.62 mm janë shkrepur nga pistoleta Zastava 7,65 x 25 mm në posedim të Xhafer Belegu;
- Në vendin e krimit, katër fishekë të shkrepur me pistoletë të përdorur nga viktima, janë gjetur nga ana e policisë afër vrimës (gëzhojat janë shënuar në skicën e datës 24 Gusht 2003 me numrat 2, 3, 4 dhe 6) kurse gëzhoja e pestë e shkrepur me pistoletë të njëjtë është gjetur në afërsi të ballkonit të shtëpisë së viktimit (gëzhoja është shënuar në skicën e mësipërme me numër 7); dy gëzhoja të shkrepura me pistoletë të përdorur nga ana e të pandehurit (të shënuar në skicë me numrat 8 dhe 16) janë gjetë në oborrin e shtëpisë së viktimit dhe më saktësisht në rrugën që çon për në garazh);
- Dëshmitari ekspert, Isa Kalijani, ortoped, i shqyrtuar në seancën e datës 21.01.2004 (deklarata e tij në shqyrtimin kryesor aktual është përfshirë në bazë të pëlqimit të të gjitha palëve), deklaroi se Rexhep Maznikolli kishte pësuar pesë lëndimeve të shkaktuara nga një armë zjarri (një në gjoks, dy në krahavor të djathtë, një në pjesën e legenit të tij dhe një në gishtin emadh të dorës së tij të majtë);
- Dëshmitari ekspert Arsim Gërzhaliu, ekspert i mjekësië-ligjor, u shqyrtua në seancën e datës 08.05.2007 (deklarata e tij në shqyrtimin kryesor aktual është përfshirë në bazë të pëlqimit të të gjitha palëve), deklaroi se Rexhep Maznikollin e kanë goditur katër plumba dhe se një nga këto plumba e ka goditur atë dy herë (së pari në gjoks dhe, pas daljes, në krahun e djathtë).

Këto rrethana duket të jenë të qarta dhe ka dyshim, me gjithë përpjekjet e palës së dëmtuara për të mohuar se Xhaferi kishte shtënë në Rexhepin. Megjithatë pozita e 4 gëzhojave të zbrazura nga pistoleta e Xhaferit, si dhe plagët e pësuar nga Rexhepi e bëjnë të qartë dhe dëshmojnë se ai u plagos nga ana e viktimit, i cili pa dyshim qëlloi në të.

Në anën tjetër, poashtu fakti se i pandehuri qëlloi në viktimën dhe e vrau atë është e pakontestueshme.

Prandaj, në bazë të rrethanave të mësipërme, kjo është çështje për të vlerësuar nëse i padituri ka vepruar në kuadër të Mbrojtjes së Duhur/Nevojshme ose, të kundërtën, ka kryer veprën penale të Vrasjes së Provokuar, në kundërshtim me Nenin 33 të LPK-së, apo ka kryer veprën penale të Vrasjes, në kundërshtim me Nenin 30 të LPK-së (dispozitat e s sipërme të LPK-së ajnë më të favorshme se sa dispozitat përkatëse të KPK-së, prandaj të mëparshmet janë të aplikueshme).

Sigurisht, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i duhur, është e nevojshme për të rikonstruar tërësisht sjelljen e të pandehurit dhe protagonistave të tjerë në këtë ngajrë.

Siç është vënë tanimë në dukje, raporti i vendngjarjes ka nënvizuar se katër gëzhoja të shkrepura nga pistoleta e viktimit (të shënuara në skicë me numrat 2, 3, 4 dhe 6) u gjetën në afërsi të vrimës në rrugë, ku grindja midis Xhafer Belegut dhe Rexhep Maznikollit kishte filluar.

Vlen të theksohet se pjesa e mësipërme të dëshmimeve objektive është krejtësisht në përputhje me tregimin e të gjithë dëshmitarëve, si për faktin se të dy burrat kishin filluar të fajlosohen kur

ata gjendeshin në afërsi të vrimës dhe se fjalosja u degjenerua deri në pikën që Xhafer Belegu filloi të shtënat.

Pëkundër asaj që u tha nga të afërmit e viktimës (i cili ka deklaruar se Xhafer nuk ka shtënë në Rexhepin), është e qartë nga plagët e pësuar nga ky i fundit (i cili u godit nga katër plumba) se Xhaferi qëlloi të paktën katër herë kundër Rexhepit.

Sa për të shtënat e shkrepura nga ana e viktimës, një tjetër gëzhojë (e shënuar në skicëen e mësipërme me numër 7) u zbraz nga pistoleta e tij dhe është gjetë në vendin e krimit brenda oborrit të shtëpisë së viktimës, në afërsi të shkallëve të ballkonit ku gruaja Xhafer's dhe vajza gjendeshin kur filloi grindja.

Sa i përket kësaj të shtënë, ajo duhet të jetë vlerësohet së pari nëse apo i është drejtuar Rexhepit ose Ventorit dhe nëse ishte e para ose e fundit nga të pesë të shtënat e shkrepura nga ana e Rexhepit (mbetet të vlerësohet nëse ai qëlloi më shumë se pesë herë).

Në këtë pikë, të afërmit e viktimës kanë deklaruar se e shtëna e parë e shkrepur nga ana e Xhaferit ishte në ajër dhe, sidoqoftë, është bërë zbrazja ndërsa Xhaferi ishte në makinën e tij afër portës së oborrit të shtëpisë së tij.

Eksperti balistik, Hazir Kelmendi, (deklarata e datës 08.05.2007, e përfshirë në shqyrtimin kryesor në baze të pëlqimit të të gjitha palëve) shpjegoi se gëzhoja e shënuar me nr. 7 në skicë është zbrazur nga një person që ka shtënë nga ana e majtë e kopshtit, në afërsi të shkallëve të ballkonit të shtëpisë së viktimës.

Prandaj pozita e qitësit me revole është absolutisht në mospërputhshmëri me atë që tregon dëshmitarët kur përshkruajnë të shtënën e parë në ajër. Prandaj e shtëna nr.7 nuk është e para që është shkrepur nga ana e Xhaferit, por ka gjasat më të mëdhaja janë se ka qenë e fundit, pasi që të gjithë dëshmitarët e shqyrtuar raportuan lidhur me çastin kur Xhaferi, pasi kishte qëlluar nga makina e tij tek porta e oborrit të tij, e nget makinën brenda në oborr dhe ecë këmbë në drejtim të garazhës së tij, pranë të cilës në fund u godit nga të shtënat e të pandehurit.

Meqë Rexhepi u godit nga katër plumba, në mënyrë që versioni i dhënë nga ana e palës së dëmtuar të jetë i besueshëm (që do të thotë se të paktën e shtëna e parë u shkrep në ajër), Xhaferi duhet të ketë shtënë tri herë në Rexhepin nga porta dhe për herë të fundit nga pozita afërt ballkonit brenda shtëpisë në oborrin e tij.

Megjithatë shumë pak gjasa ka se ky ka qenë skenari: në fakt, dëshmitarët e shqyrtuar në lidhur me këtë pikë kanë theksuar se, pasi që u qëllua, Rexhepi ra në gjunjë dhe nuk lëvizi më. Prandaj do të ishte shumë e çuditshme që Xhaferi, pasi ka hyrë në oborrin e tij, ishte këthyer përsëri në drejtim të Rexhepit dhe kishte vendosur të qëllojë nga distanca kundër një kundërshtari, i cili ishte ende në gjunjë.

Në të kundërt, gjasat janë më të mëdhaja se ai nuk ka shkrepur asnjë të shtënë në ajër kur ishte tek porta e oborrit të tij, por nga ajo pozitë ai qëlloi katër herë në Rexhepin, duke i shkaktuar atij pesë lëndime. Ky rikonstruim konfirmohet disi me dëshminë e vet Rexhepit, i cili edhe pse nuk mund të jetë i përpiktë për numrin e të shtënave kundër tij, gjithmonë e ka mohuar se e shtëna e parë e shkrepur nga ana e Xhaferit ishte në ajër.

Pra, sa i përket të shtënës së pestë të shkrepur nga ana e viktimës? A është shkrepur në drejtim të Rexhepit apo Vektorit?

Rexhepi, në deklaratat e dhëna gjatë fazës hetimore dhe në shqyrtimin kryesor, pohoi se Xhaferi, pasi që djali i Rexhepit ishte shfaqur në vendin e krimit, filloi të shkrepë të shtëna disa herë në drejtim të Vektorit.

Fakti se Rexhepi qëlloi në Vektorin disa herë është cekur edhe nga ana e nënës së të pandehurit (edhe pse ajo nuk mund të përcaktonte, madje as për afërsisht, sa të shtëna janë shkrepur), si dhe nga Sanije Hoxh, e cila tha se kishte dëgjuar disa të shtëna dhe për këtë arsye supozonte se Vektorin dhe Rexhepin qëllonin në njëri-tjetrin.

Nga anën tjetër, bashkëshortja dhe e bija e viktimës fuqimisht e mohuan se Rexhepi kishte qëlluar kundër Vektorit.

Është e qartë se të gjitha dëshmitë duhet të trajtohen me kujdes të veçantë, pasi të gjithë dëshmitarët e kanë një marrëdhënie të fortë prindëror ose me të pandehurin ose me viktimën dhe të gjithë dëshmitarët kanë për tendencë të lehtësojnë përgjegjësinë e të afërmit dhe për të rrisin përgjegjësinë e kundërshtarit të përfshirë në aksident.

Përjashtimi i vetëm në tendencën aktuale është Sanije Hoxha, e cila pavarësisht se ishte e afërme e viktimës, ka deklaruar se Vektorin dhe Xhaferin kanë shkrepur të shtënat kundër njëri-tjetrit. Sidoqoftë, lidhur me këtë pikë dëshmia e dëshmitarit duhet të konsiderohet si e pabesueshme për arsyet në vijim: së pari në të gjitha deklaratat që ajo i kishte dhënë para fillimit të shqyrtimit aktual kryesor (si gjatë fazës hetimore edhe gjatë shqyrtimit të mëparshëm kryesor) ajo asnjëherë nuk e ka përmendur këtë rrethanë të rëndësishme përpara. Për më tepër, doli se dëshmitari vetëm dëgjoji disa të shtëna dhe për këtë arsye ajo vetëm supozoi se Vektorin dhe viktima ishin duke shkrepur të shtënat në njëri-tjetrin, meqë nuk mund të shihet vëllain e saj, i cili ishte në pjesën e prapme të shtëpisë, ndërsa ajo ishte në pjesën e parme të shtëpisë.<sup>16</sup>

<sup>16</sup> *Procesverbal i shqyrtimit kryesor nga séance e mbajtur më 03.06.2010, faqe 39-40*

*Gjyqtari kryesues: Nuk isha plotësisht i përpiktë, në deklaratën e juaj të mëhershme nuk e keni përmendur se ata shtienin në njëri tjetrin, por në anën tjetër është e vërtetë se nuk ekziston asnjë fjali që thotë se ata nuk shtienin në njëri tjetrin. Keni të drejtë, nuk isha i përpiktë. Përsëri pyes, a jeni e sigurtë se ata shtienin në njëri tjetrin dhe nëse jeni të sigurtë si e dini këtë?*

*Sanije Hoxha: Vëllau im ishte në kopsht dhe i pandehuri ishte tek cepi i shtëpisë dhe mendoj se isha e qartë. Kur dikush më sulmon në shtëpinë time, është gjë normale se mua më duhet të mbrojtë veten.*

*Gjyqtari Kryesues: Pra, përsi juve supozoni. Juve thonë se ata shtienin në njëri tjetrin sepse sipas jush, kur dikush sulmon, juve supozoni se është gjë normale t'i përgjigjeni.*

*Sanije Hoxha: Saktë.*

*Gjyqtari Kryesues: Zonjë, a mund të thuani saktësisht sa të shtëna keni dëgjuar pasi që i pandehuri kishte hyrë në oborin e vëllait të juaj.*

*Sanije Hoxha: Më duket se juve me shtroni pyetjen e njejtë. E kam cekur më herët se nuki i kam numëruar të shtënat.*

*Gjyqtari Kryesues: Në rregull, mbase kanë qenë 2-3-4, a nuk ishit në gjëndje ta thuani?*

*Sanije Hoxha: Jo, nuk jam në gjëndje ta them.*

*Gjyqtari kryesues: Pra, mbase ka qenë vetëm një?*

*Sanije Hoxha: Jo, nuk është e mudhur sepse më një të shtëna nuk ka mund të vritet.*

*Gjyqtari Kryesues: Mendoni vëllau i juaj?*

*Sanije Hoxha: Sipas mendimit tim.*

*Gjyqtari kryesues: A është e mudhur se këtu kemi dy të shtëna?*

Për më tepër asnjë gëzhgjë e shkrepur nga ana e Xhaferit nuk është gjetur as në shtegun që shpie në garazh e as në pjesën e prapme të shtëpisë, që do të thotë se viktima nuk ka shtënë gjë sa ishte në kopsht në pjesën e prapme të shtëpisë.

Për arsyet e mësipërme, dëshmitë që pohojnë se viktima dhe i pandehuri kanë shtënë në njëri-tjetrin nuk duket të jenë në gjendje për të përballur në mënyrë efektive dëshminë solide dhe objektive se Xhaferi ka shtënë gjatë gjithë kohës së incidentit vetëm pesë herë, meqë pesë qëzhoja të sjkrepura nga pistoleta e tij u gjetën në vendin e ngjarjes dhe është e pamohueshme se (të paktën) 4 të shtëna janë shkrepur kundër Rexhepit.

Sa i përket të shtënës së pestë, mund të ketë qenë drejtuar kundër Rexhepit, por ka gjasa të mëdhaja se e kishin në shënjestër Ventorin, i cili pasi e kuptoi se i ati i tij ishte goditur, i afrohej shtëpisë së Xhaferit duke mbajtur një armë. Pasi u tërhoq brenda oborrit të shtëpisë së tij dhe e kuptoi se Ventori vinte pas tij, Xhaferi e shkrepri një të shtënë një herë (kjo është e shtëna e pestë shkrepur, që ka të bëjë me gëzhgjën numër 7) kundër Ventorit nga pozicioni afër ballkonit dhe pastaj u nis në drejtim të garazhës dhe pjesës së pasme të shtëpisë.

Por, pavarësisht nga fakti nëse është shtier ndaj Ventorit apo Rexhepit, ajo që është e rëndësishme është se e shtëna që ka të bëjë me qëzhojën numër 7 ishte e fundit që e shkrepri Xhaferi, meqë në vendin e krimit nuk janë gjetur më gëzhgjë të shkrepura nga revolva e tij.

Sa për veprimet e ndërmarra nga i pandehuri, të gjithë dëshmitarët dhe madje edhe vet i pandehuri ka pohuar se ai doli nga shtëpia e tij, verifikoi nëse babai i tij ishte ende gjallë, hyri në oborrin e Xhaferit dhe pastaj u fsheh pas shtyllës në cep të shtëpisë së viktimës (shtylla është e shënuar me shkronja A në skicë). Ai shtiu në viktimën nga ajo pozitë, ndërsa Xhaferi ishte në një shteg të vogël brenda oborrit që çonte në garazhin e shtëpisë.

Duke pasur parasysh pozitën e gëzhgjës të shënuar me numrin 7 në skicë, duket e pamohueshme se e shtëna e mësipërme u shkrep para se të arrinte Ventori në shtëpinë e viktimës dhe të fshehej pas shtyllës. Nëse është shkrepur e shtëna kundër Ventorit, atëherë ajo u shkrep gjersa ai i afrohej shtëpisë së viktimës.

Në rrugicën që çon në garazh janë gjetur vetëm dy gëzhgjë (të shënuar në skicë me numrat e 8 dhe 16) dhe që të dyja janë me pistoletë të kalibrit 7,65 që është përdorë nga i pandehuri. Prandaj, nga provat objektive që janë marrë në vendin e krimit, duket se viktima nuk ka shtënë në të pandehurin gjersa ky i fundit fshihej pas shtyllës.

Lidhur me këtë pikë, duhet pasë parasysh se, siç rezulton nga ekspertiza balistike e datës 26 Shtator 2003, karikatorja e pistoletës që është përdorë nga viktima ishte bosh, që do të thotë se pasi që kishte shkrepur pesë herë, Xhaferi qartë kishte mbetur pa plumba (dhe kjo ka shumë gjasa që ishte arsyeja pse ai ishte duke u terhequr nga vendi i krimit dhe shkante drejt garazhës) dhe kur gjendej në shteg nuk mund të shtiente më në të pandehurin, madje edhe po të kishte dashur të bënte këtë.

Vlen të përmendet se gruaja e viktimës ka deklaruar para trupit gjykues se i pandehuri, para se të qëllonte në Xhaferin, i tha atij: "Mos ik". Lidhur me këtë pikë, deklaratën e dëshmitarit

duket se është e sinqertë: dhe është plotësisht në përputhje me atë që ajo tha gjatë hetimeve dhe kur iu shtrua pyetja lidhur me këtë pikë nga ana e Gjykatësit Kryesues asaj menjëherë iu kujtua kjo epizodë (dhe, sinqerisht, është e paparamendueshme që Kimete Belegu , një grua që nuk njeh fare ligjin penal, qëllimisht gënjeu dhe ia vuri në gojë të pandehurit fjalët e mësipërme, në mënyrë që të bëjë pozitën e të pandehurit në papajtueshmëri me kërkesën e Mbrojtjes së Duhur).

Një mbështetje shtesë dhe objektive për besueshmërinë e rikonstruimit të mësipërm është dhënë nga rezultatet e autopsisë dhe nëpërmjet të ekzaminimit të dëshmitarit ekspert Dr Gërxxhaliu (shih deklaratën e dhënë më 8 Maj 2007).

Eksperti tha se drejtimi i predhës që vrau viktimën ishte nga e para në drejtim mbrapa, nga lart në kahje poshtë dhe nga ana e majtë pakës në të djathtë.

Fotografitë e kufomës së viktimës, të cilat tregojnë plagën hyrëse (të pozicionuar pakës më poshtë biberonit të gjinit të djathtë) dhe plaga dalëse (e pozicionuar në afërsi të veshkës së djathtë dhe në një distancë prej 12 centimetra nga vija mesatare anatomike), çojnë në konkluzionin se viktimë, kur u qëllua, nuk ishte krejtësisht përballë të pandehurit, por pjesërisht i kthyer në drejtim të murit të shtëpisë.

Pozita e mësipërme e viktimës e bënë të mendohet se Xhaferi jo vetëm që nuk shkrepur të shtëna ngjersa ishte në shtegun që çonte në garazhë, por se ishte duke shkuar drejt garazhës dhe, i thirrur nga i pandehuri, ishte kthyer në drejtim të tij, kur u godit .

Prandaj vlerësimi i pjesëve të provave të paraqitura mund të çojnë në vetëm një përfundim: se viktimë nuk ishte duke e sulmuar fare Ventorin (gjë që është logjike, pasi që kishte mbetë pa plumba), por e kundërta, tërhiqej në drejtim të garazhës dhe pjesës së pasme të oborrit, kur u qëllua nga Ventor.

Dhe rrethana që, gjersa Xhaferi u godit, ai ishte pikërisht në atë rrugicë gjë që është dëshmuar jo vetëm nëpërmjet të dëshmisë së Kimete Belegut, e cila tha se e gjeti burrin e saj në atë rrugicë, i shtrirë për tokë, në të vërtetë, provat vendimtare se viktimë ishte aty është dhënë nga vetë i pandehuri, i cili ka deklaruar se ai shtiu në Xhaferin duke e zgjatur dorën e tij nga shtylla, ndërsa fshehej pas saj. Dhe nga ky pozicion Xhaferi mund të ketë qenë goditur vetëm nëse ka qenë në rrugicë që çon në garazhë.

Versionin e dhënë nga i pandehuri dhe nga të afërmit e tij se gjersa Ventori ishte i fshehur prapa shtyllës, Xhaferi shtiente në atë është mohuar nga provat objektive se asnjë gëzhojë e përdorur në pistoletë në shfrytëzim të viktimës nuk është gjetë në shtegun të çon në garazhë (dhe rëndësia kryesore e kësaj prove është theksuar nga Gjykata e Lartë në të dy aktgjykimet e lëshuar në rastin aktual).

Avokati mbrojtës në fjalën e tij përfundimtare sygjeroi se do të ishte gabim të mbështetemi në raportin e vendit të krimit, pasi që mund të ketë ndodhur se më shumë se pesë të shtëna janë shkrepur nga ana e viktimës dhe se nuk janë gjetur të gjitha gëzhojat nga ana e policisë.

Kjo mundësi, edhe pse nuk mund të shpërfillet në abstrakte, megjithatë duket shumë e vështirë. Në fakt vendi ku ndodhën ngjarjet është shumë e kufizuar, jo e gjerë, pa bar dhe për këtë arsye nuk ka gjasa që qëzhoja të tjerë janë shkrepur dhe nuk janë gjetur nga policia.

Përveç kësaj policia arriti në vendin e ngjarjes jo shumë kohë pas incidentit (rreth 20 minuta më vonë) dhe është e paparamendueshme se gjatë asaj hapësire kohore të afërmit e viktimës qëllimisht mund të kenë larguar disa gëzhoja të shkrepura me pistoletë të viktimës, me qëllim për të fshehur provat që mund të kenë qenë përdorur kundër tij.

Prandaj duhet pohuar se, pasi ka qëlluar 4 herë kundër Rexhepit, Xhaferi shkoi në drejtim të shtëpisë së tij, pastaj qëlloi edhe një herë (sipas te gjitha gjasave kundër Ventorit) dhe pasi ka mbetë pa plumba shkon drejt garazhës dhe pjesës së pasme të shtëpisë së tij kur hyri Ventori në oborrin e viktimës, u fsheh pas shtyllës së shtëpisë, iu drejtua Rexhepit me fjalët si më lartë dhe e goditi në gjoks me plumb vdekjeprurës.

NëLidhur me këtë pikë vlen të theksohet fakti se palët e dëmtuara janë konsideruara si jo të besueshme lidhur me pikën se viktima shkrepri të shtëna në ajër dhe jo kundër Rexhepit nuk duhet dëshmia e tyre domosdoshmërisht të hidhet poshtë.

Në fakt është një parim i përgjithshëm që një deponim mund të shkruhet lidhur me besueshmërinë e tij, do të thotë që gjyqtari mund të trajtojë disa pjesë të deklaratës si të besueshme, sepse janë vërtetuar nga elemente të forta dhe objektive të konfirmimit, dhe të hedhë pjesë të tjera të deklaratës që janë kundërshtuar nga elemente të sigurt. Vlerësimi i pabesueshmërisë sa i përket pjesëve të deklaratës që janë hedhur poshtë, nuk ndikon në kredibilitetin e pjesëve të tjera të deklaratës të trajtuara si të besueshem.

Pasi ka vlerësuar se si ishte gjendja faktike, ajo duhet të vlerësohet nëse sjellja e të pandehurit mund të përshkruhet ose jo si një akt i Duhur i Mbrojtjes.

Para së gjithash, lidhur me këtë çështje, pasi që krimi është kryer kur KPK-ja nuk ishte në fuqi, duhet të përcaktohet nga dispozitat që lidhen me Mbrojtje të Duhur është më e favorshme, Neni 9 KPRSFJ-së apo Neni 8 i KPK-së.

Midis dy dispozitave, që duhet të mos vlerësohen në mënyrë *in abstracto*, por në raport me zbatimin e tyre konkrete për rastin, më e favorshme duket të jetë Neni 8 KPK-së, meqë ajo nuk kërkon që akti i mbrojtjes është absolutisht i nevojshëm (e vërtetë është se, në anën tjetër, Neni 9 i KPRSFJ nuk kërkon proporcionalitet, i cili është i parashikuar në Nenin 8 të LPK-së, por me jurisprudence të vazhdueshme lidhur me Nenin 9 në kuptimin se proporcionaliteti është megjithatë imanent në dispozitë).

Sipas Nenit 8 të KPK-së, një akt i Mbrojtjes së Duhur kryhet atëherë kur kryhet drejtpërdrejtë për të shmangur një sulm të paligjshëm, reale dhe të menjëhershëm kundër personit që reagon ose ndaj një personi tjetër.

Është e pakontestueshme se sulmi i viktimës kundër babait të të pandehurit ka qenë i paligjshëm, sepse nuk ishte proporcional (nuk është e qartë nëse Xhaferi është sulmuar ose jo me një shufër hekuri nga ana e Rexhepit, por në çdo rast reagimi i tij ishte përfundimisht i tepruar).

Megjithatë, kur Ventor filloi të shkrepë të shtëna në viktimën, sulmi kundër babait të tij tashmë kishte përfunduar si dhe vet sulmi kundër Ventorit, nëse ka pasur ndonjë sulm fare. Xhafer kishte mbetë pa plumba dhe nuk mund të gjuante më, ai ishte në oborrin e tij, duke shkuar drejt garazhës dhe pjesës së pasme të shtëpisë dhe për këtë arsye nuk e sulmonte me çdo mjet të pandehurin.

Prandaj jo vetëm që nuk kishte ndonjë sulm kundër të pandehurit, por në të vërtetë nuk kishte asnjë lloj sulmi dhe Ventor nuk ishte në situata të detyruar për të mbrojtur veten ose babain e vet. Po ashtu nuk kishte nevojë për të hyrë në oborr të Xhaferit dhe të shkojnë pas viktimës.

As nuk mund të thuhet se duke shtënë i pandehuri ka tejkaluar kufijtë e Mbrojtjes së Nevojshme. Në fakt, në mënyrë që të tejkalohet kufiri është e nevojshme që kushtet për Mbrojtje të Nevojshme ekzistojnë, ndërsa, në rastin në fjalë, për shkak të mungesës së ndonjë sulmi të mundshëm apo të vazhdueshëm, kushtet e mësipërme plotësisht mungojnë, meqë sulmi tashmë kishte përfunduar kur Ventori ka shtënë dhe nuk ekzistonte rreziku për një sulm tjetër.

Vlen të theksohet se konkludimi i më sipërm është në përputhje me jurisprudencën në lidhje me Nenin 48 të Ligjit Penal të Serbisë, dispozitë e cila është pikërisht e njëjtë me Nenin 33 të LPK-së. Në fakt, sipas asaj jurisprudence, në qoftë se sulmi i palës së dëmtuar ka pushuar tashmë nga momenti kur i akuzuari shkrepri të shtëna dhe reagimi i të akuzuarit pasoi si pasojë e gjendjes së zemërimit të rëndë, në të cilën ai u solli nga sjellja e palës së dëmtuar, kjo është një çështje e veprës penale të vrasjes nga afekti dhe jo të mbrojtjes së nevojshme (Gjykata e Qarkut në Beograd, vendimi K 172/91, 11 Qershor 1991 dhe Gjykata e Lartë e Serbisë, Kz 635/91, 8 Tetor 1991).

Nëse përjashtohet se i padituri ka vepruar në Mbrojtje të Nevojshme, duhet marrë në konsideratë nëse vrasja është kryer në kushtet e parashikuara nga Neni 33 i LPK-së, e cila krejtësisht korrespondon me Nenin 48 të LPK-së (dhe për këtë arsye dispozita e mëparme është e zbatueshme, pasi që ishte ligji në fuqi në kohën e kryerjes së krimin).

Elementet e veprës penale të vrasjes së provokuar janë si në vijim:

1. Kryesi, në momentin kur e ka kryer veprën penale, ishte në një gjendje të zemërimit.
2. Kryesi pa fajin e tij u soll në një gjendje të tillë nga një sulm apo një fyerje e rëndë nga personi i vrarë.
3. Se vrasja ishte e provokuar.

Së Pari: akti duhet të jetë i kryer në gjendje të zemërimit. Kjo gjendje është përcaktuar nga doktrina dhe jurisprudenca si një gjendje e jashtëzakonshme mendore që në thelb zvogëlon kapacitetin e një personi për të menduar dhe reaguar në mënyrë normale. Përveç kësaj është përcaktuar si një gjendje e veçantë e *afektit* mendor të vetëdijes së reduktuar, kapacitet të zvogëluar për të menduar dhe reaguar në mënyrë të duhur, shoqëruar me manifestime të jashtme fizike, e kushtëzuar me një ngacmim të caktuar të fortë emocionale të karakterit të përkohshëm. Me fjalë të tjera, vrasja duhet të kryhet në një gjendje të tillë të jashtëzakonshme mendore e cila nga intensiteti i saj çon në një agjitacion të tillë të autorit të krimin që ai menjëherë pa menduar merr vendim për kryerjen e vrasjes në afekt dhe vepron menjëherë në ëprputhje me rrethanat.

Prandaj, gjendja e afektit mund të jetë stoike dhe këto janë afekte që shtojnë aktivitetin mendor dhe fizik (zemërimi, tërbimi) ose astoike, që janë afekte që e ndrydhnin dhe frenojnë këtë aktivitet (pikëllim, frikë dhe të ngajshme)

Është e padiskutueshme se gjendja e irritimit të rëndë nuk përfshinë kushtet patologjike të vetëdijes së reduktuar, të provokuar nga disa lloj sëmundje mendore, apo një strukturë e veçantë e psikopatisë të personalitetit.

Së dyti: një sulm apo një fyerje e rëndë. Doktrina dhe jurisprudenca e kanë përcaktuar konceptin e mësipërm të parashikuar në Nenin 33 të LPK-së. Në veçanti një sulm nënkuptohet si aktivitet i llojit që rrezikon ose dëmton integritetin fizik të një personi. Megjithatë, një sulm nuk duhet të jenë patjetër i drejtuar në kryesin e veprës penale: një sulm mund të jetë i drejtuar ndaj një personi të afërt të kryesit të veprës penale dhe termi "person i afërt", nuk duhet të kufizohet vetëm tek afërmit e ngushtë, por persona të tjerë të dashur të autorit të krimit duhet të konsiderohen si të tillë. Është e qartë se një lidhje i rastit duhet të ekzistojë në mes të një sulmi dhe gjendjes së afektit, do të thotë se sulmi duhesh ardhur nga personi i vrarë. Poashtu është e qartë se autori i vrasjes nuk duhet të ketë provokuar sulmin me çdo mjet.

E treta: vrasja duhet të jetë e provokuar. Vrasja e provokuar do të thotë me ia marrë jetën e një personi menjëherë pasi që provokimi ka ndodhë. Shtrohet pyetja se çfarë periudhe kohore duhesh kaluar në mes të provokimit dhe vrasjes në mënyrë që ajo të jetë vrasje e provokuar. Në përgjigje kësaj pyetjeje duhet pasur aparasysh se ky akt mund të kryhet vetëm gjatë kohës së zemërimit të rëndë. Normalisht, ajo zgjatë një kohë të shkurtër. Në çdo rast, në mes të një sulmi dhe vrasjes duhet të ekzistojë një vazhdimësi dhe vrasja duhet të jetë "një reagim i menjëhershëm ndaj sulmit të paprovokuar" (shih, Gjykata e Lartë e Serbisë, Kz.Nr. I-1309/95 i datës 12 Dhjetor 1995).

Posa dispozita e parashikuar në Nenin 33 LPK-së të analizohet, duket qartë dhe evidente se rasti aktual në fjalë i plotëson të gjitha kërkesat e vrasjes së provokuar.

Në fakt, dëshmitarët ekspertë deklaruan se vrasja ishte kryer në një gjendje të nxehjes emocionale nga i padituri, siç rezulton nga abstrakti i procesverbalit të 2010/07/21:

*Gjyqtari Kryesues: Mbase mund të shtoni pakës më shumë sa i përket përkufizimit të kësaj gjendjeje të veçantë mendore. Sipas përvojës së juaj dhe ajo që keni mësuar nga ky rast, a ishte i pandehuri, pasi e ka parë babain e tij të sulmohej, në një gjendje mendore të intensiteti të tillë nga e cila menjëherë e çon atë të marrë vendimin e kryerjes së vrasjes, pa menduar më shumë?*

*Dr.Nazife Sylejmani: Po. Mund të themi se ai ishte në një gjendje të tillë mendore të intensitet për të marrë një vendim të pa menduar.*

*Gjyqtari Kryesues: Ju falemnderit, ju keni një çasje krejtësisht tjetër kur përgjigjeni! E çmojë kur dikush shkon drejtë në çështje. Po në lidhje me kapacitetin e tij të të kuptuarit të rëndësisë së veprimit të tij? A ishte ky kapacitet i zvogëluar ose i gjallë nga një shqetësim mendor, ose një sëmundje mendore apo jo? Po flas për një gjendje patologjike.*

*Dr Nazife Sylejmani: Ai nuk vuante nga asnjë lloj sëmundjeje psikiatrike.*

*Gjyqtari Kryesues: Por vlerësimi juaj është se për shkak të sulmit që përjetoi babai i tij dhe marrëdhëniet mes dy familjeve, ai në çast humbi aftësinë e tij për situatën dhe mori një vendim të çastit të kryerjes së vrasjes?*

*Dr Nazife Sylejmani: Do të thoja, po. Sepse në atë moment kur ai shtiu në personin, ai përfjetoi shpërthimin e afektit, afekti shpërtheu nga mendja e tij. Në kuptimin e zbrastësisë, ai e zbrasi afektin. Ose shkarkoi afektin e tij. Dhe menjëherë pas kësaj personi mund të ketë pasur një lloj amnezie të pjesërishme, nuk mund t'i kujtohen gjerat në ato çaste.*

*Gjyqtari Kryesues: Vlerësimi juaj se kapaciteti i tij ishte zvogëluar është bërë poashtu për shkak se i pandehuri vazhdimisht thoshte se nuk mund të mbante në mend se çfarë kishte ndodhur?*

*Dr Nazife Sylejmani: Jo, ne nuk e kemi vlerësuar në bazë të asaj që ai na tha, ne jemi bazuar në atë që ai e tha, si dhe leximi i literaturës. Literatura e thotë si në vijim se në ato momente pasi personi të shkarkojë afektin e vet, pas shkarkimit të afektit ai/ajo vuan nga një lloj amnezie, dhe natyrisht kur është fjala për detajet e ngjarjes, nuk i kujtohen detajet se çfarë ka ndodhur. .*

*Gjyqtari Kryesues: Kjo është natyrisht se çfarë thotë literatura. Meqë i pandehuri me sa duket nuk mund të mbajë në mend të gjitha detajet që ju i lidhni me atë që u tha nga i pandehuri dhe çfarë thotë literatura? Natyrisht se kjo është logjike?*

*Dr Nazife Sylejmani: Po kështu qëndron. Siç ju tha kolegu im neve i bazojmë rezultatet tona në mënyrë që ai ka intervistuar, mënyrën se si e kemi konsultuar literaturën dhe kemi dhënë konstatimet tona.*

*Gjyqtari Kryesues: Po çka në lidhje me veprimin e tij të fshehjes pas shtyllës, a jeni dakord se ky veprim mund të përkufizohet si një veprim instinktiv?*

*Dr Nazife Sylejmani: Po mund të definohet ashtu.*

*Gjyqtari Kryesues: Ok, z. Prokuror, ndonjë pyetje?*

*Ali Uka, Lokale Prokurori: nuk kam pyetje.*

*Gjyqtari Kryesues: Pala e dëmtuar ndonjë pyetje? Kimete Belegu ndonjë pyetje?*

*Kimete Belegu: Nuk kam.*

*Gjyqtari Kryesues: Pala e dëmtuar, Gëzim Belegu, keni ndonjë pyetje?*

*Gëzim Belegu: Nuk kam pyetje.*

*Zenel Mekaj, Avokati Mbrojtës: Ju keni hulumtuar çështjen mjaft shumë. Besoj dhe jam i mendimit se pas të gjitha këtyre përpjekjeve, tani çështja është shumë më e qartë në ekspertizën e dhënë për ne, në pjesën e analizave, kjo pjesë merret më shumë me akumulimin e stresit si pasojë e marrëdhënieve të mëparshme midis ato familjeve, atëherë ajo merret më shumë me atë se me rastin aktual. Kur i ndjeri Xhafer Belegu plagosi babain e të akuzuarit me gjashtë plumba, dhe në momentin kur i akuzuari e kuptoi se babai i tij ishte plagosur, ky është kulmi i momentit që rezultoi në gjendjen e afektit të tij. Dhe kjo nuk është përmendur në këtë pjesë të analizave, për këtë arsye, pyetja ime do të ishte: a munden ekspertët të na tregojnë, nëse shkakun kryesor i gjendjes afektive i të pandehurit është fakti se babai i tij është plagosur në këtë sulm? Ndërsa në lidhje me rrethanat e tjera, rrethanat e tjera mund të jetë vetëm sekondare në këtë rast.*

*Gjyqtari Kryesues: Dr Nazife Sylejmani, ndoshta ju mund t'i përgjigjeni kësaj.*

*Dr Nazife Sylejmani: Kushtet e analizuarra që ne i përshkruajmë në ekspertizën tonë, kemi parasysh marrëdhëniet e mëparshme dhe statusin e familjeve dhe neve kemi nxjerë një përfundim të bazuar në atë, që një lloj i akumulimit i afektit ka ndodhur me rastin aktual. Në ditën kritike, kemi parë se ajo ishte një shkarkim i afektit emocional. Pra, në atë moment si tha pala tjetër se ishte kulmi i gjithë kësaj ngarkese emocionale si dhe në ato momente, kjo ngarkesë e afektit emocional u shkarkua. Pra, në momentin ai nuk ishte në gjendje të mendojë logjikisht, të kontrollojë veprimet e tij si dhe të kontrollojë veten e tij siç duhet, sepse*

*në çdo kohë efektet e ngarkesës janë në kërkim të momentit të shkarkimit të efektit. Ky ishte momenti që akumulimi emocional apo emocionet të shpërthejnë.*

\* \* \*

*Gjyqtari Kryesues: Unë mendoj se avokati dëshiron të dijë nëse sulmi kundër babait të të pandehurit ishte rramje klasike që e bëri që ujit të ikë nga kavanozi, apo ishte diçka aq e fortë se mund të jetë shkaku kryesor i humbjes së kapacitetit për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij.*

*Zenel Mekaj, Avokat Mbrojtës: A ishte shkaku kryesor?*

*Dr Nazife Sylejmani: Po, mund të themi se ishte shkaku kryesor.*

*Gjyqtari Kryesues: A pajtoheni edhe ju Dr Bujar Berisha?*

*Dr Bujar Berisha: Po.*

Konkuzionet e mësipërme janë të konfirmuara kryesisht nga ekspertiza e bërë nga Dr. Gani Rama dhe janë të datës 23 Dhjetor 2003 (ekspertiza e mësipërme, e bërë gjatë shqyrtimit kryesor, është marrur në shqyrtimin e tanishëm kryesor në bazë të pajtimit nga të gjitha palët): "Momenti i caktuar në ditën kritike, ka qenë sikur "një pikë e vetme që zbraz gotën e mbushur" andaj ka shkaktuar zbrasje afektive dhe motorike të cilat në fund rezultuan me vrasje. Në të vërtetë i pandehuri i cili gjithë kohën para se të ndodh ngjarja ka qenë vetëm vrojtues, për shkak të parakushteve të aktit të kryer, ka qenë fuqishëm i ndikuar nga gjendja afektive që ka rezultuar në zvoglimin e vetëdijes në momentin kritik duke e bllokuar mendimin e tij kritik dhe logjik andaj ka reaguar impulsivisht dhe në mënyrë të dhunshme ( gjendje psiqike e qrrregullimit të përkohshëm).

*Duke u bazuar në përmbajtjen e letrave të kësaj lënde dhe egzaminimit të të pandehurit, Vektor Maznikoll, unë konkludoj që i pandehuri nuk vuan nga ndonjë gjendje e përhershme e qrrregullimit mendor dhe se nuk ka gjetje që e pengojnë zhvillimin e tij mendor. Gjatë ehzaminimit ai paraqet fenomenin e depresionit reagues si rezultat i gjendjes së tanishme"*

Është poashtu e pamohueshme se kryesi i veprës pa fajin e tij është sjellur në atë gjendje nga një sulm apo ofendim serioz nga ana e personit të vrarë, sepse Ventori reagoi kundër Xhaferit pasi që ai pa se babai i tij ishte lënduar dhe mbuluar në gjak nga të shtënat që shtiu Xhaferi. Vlen të përmendet se Ventori atë ditë, aspak nuk ka qenë i përfshirë në grindje lidhur me gropën andaj ai nuk ka provokuar në asnjë mënyrë reagimin e të vrarit.

Dhe së fundi, veprimet e ndërmarrura nga Ventori kanë qenë menjëherë pasojë e sulmit të viktimës dhe kanë qenë të shkaktuara dhe të nxitura nga të shtënat e të ndjerit kundër babait të viktimës.

Meqë veprimi i të pandehurit duhet të kualifikohet si Vrasje e Provokuar, paneli është i liruar nga obligimi për të vlerësuar nëse egzistojnë ose jo kushtet për vepër penale të Vrasjes.

Lidhur me këtë qështje, sikur një *obiter dictum* (mendim totalisht i panevojshëm për zgjidhjen e rastit), vlen të përmendet se kualifikimet e dhëna nga prokurori nuk janë të detyrueshme për gjykatësin, siq është e dhënë në Nenin 386 të KPPK-së.

Ky kod nuk specifikon nëse gjykatësi është i obliguar ose jo, kur rikualifikimi do të ishte në dëm të të pandehurit (psh nga Vrasja e Provokuar në Vrasje).

Andaj, në bazë të principeve të interpretimit *ubi lex voluit, dixit, ubi noluit, tacuit* (aty ku ligji dëshiron të rregulloj një qështje, e rregullon, aty ku nuk dëshiron, nuk e rregullon), duhet të konsiderohet se gjykatësi është i lirë për të riklasifikuar veprën penale pa marr parasysh faktin që është në dëm të të pandehurit.

Sidoqoftë, gjyqtari duhet të merr parasysh parimet e parashikuara nga KEDNJ e cila, sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në territorin e Republikës së Kosovës dhe në rast konflikti ka prioritet ndaj ligjeve tjera.

Në veçanti, lidhur me mundësinë e gjyqtarit për të ri-klasifikuar akuzën, dispozitat nga Neni 6, par. 3 pika a dhe b të KEDNJ duhen të merren parasysh. Dispozitat e lartcekura specifikojnë se i pandehuri ka të drejtën për të qenë i informuar lidhur me akuzën kundër tij dhe duhet të ketë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj.

Në piken kur jurisprudenca e GJEDNJ (*Drassich vs Italy*, 11.12.2007) ka treguar se nëse gjyqtari ka kompetencën për ti ri-klasifikuar akuzat ( dhe duhet të theksohet se në rastin e sipërpërmendur ishte një rikualifikim *in peius*), të pandehurit duhet ti ketë të drejtën për të qenë i informuar rreth mundësisë e kualifikimit tjetër të akuzës ( në bazë të së njëjtës sjellje) e propozuar nga prokurori, duke i ofruar gjithashtu të pandehurit të sjell prova dhe të mbrohet lidhur me klasifikimin eventual të ri.

Kështu që në rastin aktual, nëse gjykata ka pasur për qellim të ri-klasifikoj akuzën nga Vrasja e Provokuar në Vrasje, i pandehuri duhej të kishte qenë i informuar rreth kësaj mundësie në mënyrë për ti mundësuar atij të mbroj veten e tij po ashtu në baza të kualifikimit tjetër të lartpërmendur.

## **2. Parashtrësas e Palëve**

Asnjë parashtrësë nuk është parashtruar nga ana e palës së dëmtuar.

Në bazë të kërkesës së avokatit mbrojtës, deklaratat e dhëna nga i pandehuri para policisë më 23 dhe 24 gusht 2003 janë anuluar nga dosja e lendes pasi që asnjë paralajmërim nuk i u është dhënë të pandehurit në përputhje me Nenin 218 të Kodit të Procedurës.

## **F. PËRCAKTIMI I DËNIMIT**

Kur shqiptohet dënimi penal, gjykata duhet ta ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit- i cili është ti jep fund veprimeve të rrezikshme shoqërore duke i mënjanuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale- dhe qëllimit specifik të parandalimit të kryesit të veprës penale për të kryer veprën e njëjtë penale.

Në rastin aktual, trupi gjykues erdhi tek përfundimi se, se kjo ishte një vepër penale e rëndë dhe serioze e kryer kundër një personi i cili nuk ishte duke sulmuar më tutje as të pandehurin e as babin e tij dhe ishte duke u tërhequr në drejtim të kopshtit të tij dhe garazhit së shtëpisë së tij.

Pasi që viktima nuk kishte për qëllim që të ndërmarr asnjë sulm të menjëhershëm, ngjan se motivi i kryerjes së veprës penale ishte kryesisht hakmarrja për plagët e shkaktuara ndaj babait të të pandehurit. Në fakt, nuk kishte nevojë fare që Ventori të kryente krimin, por sido që të jetë, ai ishte i etur për tu hakmarrë për babën e tij.

Në thelb, vlen të përmendet se rrethana se vrasja ishte kryer në afshin e zemërimit nuk përjashton për të marrë parasysh arsyet dhe motivet e vrasjes.

Në fakt, edhe pse mundësia e vlerësimit dhe e të kuptuarit e të pandehurit ishte e zvogëluar, ajo nuk le të kuptoj se motivimi i tij nuk duhet të vlerësohet në mënyrë për të llogaritur dënimin.

Dhe motivi duket të ketë qenë e keqja dhe e shtyre vetëm nga qëllimet e hakmarrjes.

Gjithashtu sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale nuk është krejtësisht në të mirën e të pandehurit: në fakt është e vërtetë se i pandehuri ka pasur sjellje korrekte gjatë shqyrtimit kryesor të tanishëm, në shqyrtimin dytë kryesor ai është dashur që të arrestohet në mënyrë që të sigurohet prezenca e tij para gjykatës, prandaj nuk ka treguar asnjë shenjë të pendimit për vrasjen e një personi.

Në anën tjetër rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, që nënkupton faktin se babai i të pandehurit kishte qenë sulmuar, nuk mund të merren parasysh si një rrethanë lehtësuese, pasi që kjo veç me është vlerësuar me qëllimin e kualifikimit të veprës penale si Vrasje e Provokuar.

Përveç kësaj, në mënyrë që të përcaktohet dënimi i drejtë, duhet që të merret parasysh se me qëllim që të hakmerret i pandehuri nuk ka hezituuar që të kërcënoj gratë e paarmatosura dhe madje të qëllon njërin prej tyre.

Prandaj, dënimi i vlerësuar si i drejtë është tetë vite burgim duke marrë parasysh rrethanat renduese të treguara më lartë dhe faktin se nuk ka se nuk ka rrethana lehtësuese.

Koha e vuajtur në paraburgim nga i pandehuri, prej 23 mars 2007 deri më 8 maj 2007 do ti hiqet dënimit të pandehurit, në përputhje me Nenin 351 Paragrafi (1), pika 6 të LPP-së.

## **G. SHPENZIMET**

Pasi që i pandehuri duhet ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të përkthimit (Neni 351, paragrafi (1), pika 7 e LPP-së), një aktvendim i veçantë do të lëshohet nga gjykata për vlerën e shpenzimeve kur një datë e tillë të merret.

## **H. KËRKESA PËR KOMPENSIM**

Në fillim të shqyrtimit kryesor, palët e dëmtuar janë rikujtuar për mundësinë për të parashtruar një parashtrësë për të realizuar kërkesën pronësore juridike në kuadër të

procedurës penale, por ata kanë deklaruar se nuk kanë pasur për qëllim që të parashtrijnë kërkesë pronësore juridike.

Prandaj gjykata nuk ka pasur nevojë që të nxjerr një vendim specifik mbi këtë çështje.

### **Këshillë Juridike**

Personat e autorizuar mund të parashtrijnë ankesë me shkrim kundër këtij verdikti Gjykatës Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut të Pejës, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes së kopjes së aktgjykimit.

Procesmbajtësja

\_\_\_\_\_  
Robina Struthers

